



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 3663/Prot

Tiranë, më 16.12.2024

V E N D I M
Nr. 49, datë 16.12.2024

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE ME MESATARE 9 (NËNTË) - 10 (DHJETË) QË PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE DHE QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT ME 100% NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE. PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025, ME DETYRIME TË SHLYERA PËR VITIN PARAARDHËS (faza e parë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 39, datë 23.1.2019 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, të VKM Nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” e ndryshuar me VKM nr.779, datë 26.12.2018 dhe VKM Nr. 40, datë 23.01.2019 si dhe VKM Nr. 251, datë 27.3.2020 “Për një ndryshim në vendimin nr.269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, në institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 3663 Prot., datë 16.12.2024 në mbledhjen e tij të datës 16.12.2024,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve me mesatare 9 (nëntë) - 10 (dhjetë) që përfitojnë bursë financiare dhe që përjashtohen nga tarifa e shkollimit me 100 % në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, për vitin akademik 2024-2025.
2. Efektet financiare për 47 (dyzetë e shtatë) studentë me mesatare 9 (nëntë) - 10 (dhjetë) që përfitojnë bursë dhe që përjashtohen 100% nga tarifa e studimit janë në total 5,752,000 (pesë milion e shtatëqindë e pesëdhjetë e dymijë) lekë, përkatësisht:
 - a.) Bursat, në vlerën 4,230,000 (katërmilion e dyqindë e tridhjetëmijë) lekë.

b.) Përfshirja 100% nga tarifa e studimit në vlerën 1,522,000 (një milion e pesëqindë e njëzetë e dy mijë) lekë.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Sokol DURO

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Donika KËRÇINI

Anëtar

Florian NURCE

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar



Konceptoi: N. Ndoci